Shtojca 2 :

Raporti i vendimmarrjes së Komisionit të Përhershëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS
KËSHILLI BASHKIAK

Komisoni i Përhershëm për Ekonomine dhe Kontrollin e brendshem financiar

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr. 14 datë 17/ 07/ 2025

Nr 324 Prot

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Ky raport vendimarrje është hartuar edhe bazuar ne dispozitat ligjore të cituata si: Në përmbushje të kërkesës së Ligjit Nr. 10463, datë 22/09/2011 "Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve", neni 12 dhe neni 13, Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjit Nr. 10431/2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit", i ndryshuar, Ligjit Nr. 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Ligjit nr.8094, datë 21.03.1996, "Për largimin publik të mbeturinave", VKM Nr. 418/2020, "Për Miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike dhe të Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, 2020–2035", VKM Nr. 671/2015 "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", në funksion dhe në përmbushje të kuadrit ligjor mjedisor, VKM nr.418, datë 25.06.2014 "Për grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim", VKM nr.608, datë 17.09.2014, "Për masat e nevojshme për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve bio si dhe kriteret dhe afatet për pakësimin e tyre", VKM nr.333, datë 26.01.2011, "Për administrimin e vend depozitimeve rajonale të mbetjeve urbane", VKM nr.1189, datë 18.11.2009, "Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit", VKM nr.319, datë 31.05.2018, "Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve".

Situata aktuale e funksionit (përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Aktualisht ne Bashkine Hasit dhe njesite administrative nuk kane nje plan menaxhimi per mbetjet.Per kete arsye sipas ligjit cdo bashki duhet te kete te miratuar Planin e Menaxhimit t mbetjeve .Në Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planit Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve (Miratuar Maj 2020) është prezantuar një metodologji mbi bazën e prioriteteve të bashkisë për menaxhimin e mbetjeve, për të përcaktuar se cili do të konsiderohet standardi minimal për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve. Kjo metodologji propozon 5 hapa në shkallë, duke filluar nga më baziku deri tek ai më optimali, të cilët përcaktojnë standardin minimal të ofrimit të shërbimit:

Situata financiare : (Shtesa / pakësime në buxhet)

Fondet per zzbatimin e planit te Menaxhimit te Mbetjeve do te miratohen cdo vit nga Keshilli Bashkiak, permes programve te buxhetit te bashkise , dhe do te monitorohen nga Komisioni i Sherbimeve

Drejtoria / Sektori përgjegjës
Drejtoria e sherbimve

Monitorimi dhe raportimi : (kush monitoron, raporton dhe sa shpesh)

Prefekti, Keshilli

Impakti social / grupet që preken:

familjet vulnerabel

A është objekt i konsultimit publik:

Po

Komisioni i Përhershëm i Sherbimeve pas degjes publike te organizuar me date 15 korrik 2025 , i mbledhur me datën 17/07/2025, shqyrtoi projekt vendimit, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për " Per miratimin e Planit te Menaxhimit te Mbetjeve «

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak: (qarko njeren)

   b) **miratimin e projektaktit**

T'i propozojë Këshillit ndryshimet e projekt vendimit si më poshtë vijon te renditura me pika.

1. pa ndryshime

_____ **Kryetar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)

_____ **Sekretar i Komisionit**

(emri, mbiemri, firma)